



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 2-të (të jashtëzakonshme) të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 18. 12. 2017 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Diamant Bytyqi, anëtar
3. Rasim Hasani, anëtar
4. Arton Retkoceri, anëtar
5. Avni Olluri, anëtar
6. Mehmetali Krasniqi, anëtar
7. Nehat Tërpeza, anëtar
8. Fadil Sopa, anëtar
9. Vlora Limani-Hajnuni, anëtar
10. Hyra Bytyqi, anëtar
11. Linda Shahini, anëtar
12. Anila Reçica, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtar
18. Egzona Bytyqi, anëtar
19. Selatin Retkoceri, anëtar
20. Shkelzen Bislimi, anëtar
21. Albulena Kelmendi, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtar
25. Fitim Selimi, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtar
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtar
30. Arben Salihu, anëtar
31. Lulzim Qerimi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në detyrë
3. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës në detyrë
4. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH, në detyrë
5. Adem Duriqi, Drejtor i DP, në detyrë
6. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU, në detyrë
7. Nazim Gashi, Drejtor i DMSH, në detyrë
8. Imer Rrustemi, Drejtor i DI, në detyrë
9. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së në detyrë
10. Basri Hashani, Drejtor i DRSK, në detyrë
11. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
12. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHR"
13. Përfaqësues të mediave dhe
14. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 30 anëtarë nga gjithësej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se kjo është mbledhje e jashtëzakonshme ku në rend dite kemi vetëm një pikë për të cilën e keni marrë së bashku me ftesë.

Në vazhdim vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për të anëtarëve prezent të Kuvendit për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i planifikimit dhe aprovimi i buxhetit për vitin 2018-2020

Pastaj u kalua në punë sipas së njëjtës.

I

Shqyrtimi i planifikimit dhe aprovimi i buxhetit për vitin 2018-2020

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi i dha fjalën Shkelzen Hajdini drejtor në detyrë i DBF-së i cili fillimisht njoftoi të pranishmit me procedurat e hartimit të këtij buxheti e më pastaj njoftoi me të dhënat nga propozimi buxheti duke kërkuar nga anëtarët e Kuvendit që të aprovonë këtë buxhet. Në njoftimin që e keni në arsyetimin e propozimit vendimit se bazuar në qarkoret buxhetore të kategorisë për paga e medijave në drejtoratin për arsim kemi mungesë të mjeteve në shumë prej 109,439.00€.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Vlora Limani – Hajnuni, fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, Kryesuesin, anëtarët e Kuvendit dhe të tjerët prezent dhe pastaj tha se sot jemi në një seancë të jashtëzakonshme ku do të shqyrtohet buxheti i komunës për vitet 2018-2020 dhe besoj se ky buxhet edhe do të aprovohet edhe pse është dashtë të aprovohet qyshë në shtator. Unë nuk jam ekonomiste që

të analizoj këtë buxhet kod për kod por edhe pse nuk jam ekonomiste e shoh se sipas këtij buxheti ka rritje gradualisht në kodet ekonomike të cilat prekin drejtëpërsëdrejti mirëqenien e qytetarëve.

Pastaj tha se nga viti i kaluar ky buxhet ka rritje mbi 1 milion e 200 mijë euro. Kurse te investimet kapitale kemi rritje prej 800 mijë euro. Përveq kësaj me këtë buxhet shohim një përkushtim te kjo qeverisje në rritjen e cilësisë në arsim ku janë parapa mjete për blerjen e paisjeve për teknologji informative si dhe laborator për kimi, fizikë, etj. Gjithashtu me këtë buxhet është parapa edhe ndërtimi i një qerdheje të fëmijëve në Lipjan që është shumë e nevojshme sidomos për nënat që janë në madhënie punë. Në fund tha se unë në emër të grupit parlamentarë e përkrahi këtë buxhet.

Lulzim Rrustemi, fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe falenderoj Kryesuesin për fjalën dhënë e pastaj tha se sot po shqyrtojmë një dokument të rëndësishëm të qeverisjes lokale projekt buxhetin për vitet 2018-2020 dokument i cili kërkon përkushtimin tonë objektiv dhe qasjen tonë konkrete. Ky dokument i cili duhet të jetë gjithpërfshirës, i cili përfshinë një plan të përgjithshëm për realizimin e objektivave të caktuara e që kanë të bëjnë me ndarjen e mjeteve financiare për programet dhe shërbimet e caktuara për qytetarët tanë. Ky program është shqyrtuar në detaje nga grupi i anëtarëve të PDK-së dhe kanë nxjerrë përfundimet e tij se ky projekt buxhet i planifikuar dhe i propozuar për aprovim del të jetë i pa analizuar mirë, i pa konsultuar mjaftueshëm, debatuar me një numër të vogël të qytetarëve prezent në debate, jo transparent dhe në kundërshtim me kërkesat, nevojat dhe prioritetet e qytetarëve të komunës sonë e gjithashtu edhe me shkelje të mëdha ligjore. Nisur nga arsyetimi i këtij buxheti ku thuhet se janë paraqitë në mënyrë të hollësishme në tabelat e më poshtme në material është krejt e kundërta kjo në fakt nuk qëndron sepse për shumë raste nuk ka fare sqarime të shpenzimeve as te investimet kapitale ku nuk dihet sakt se ku do të investohet.

Kjo mbledhje e jashtëzakonshme sigurist e arsyeton qëllimin e thirrjes për të shqyrtu një dokument kaq të rëndësishëm projekt buxhetin 2018-2020, por asesi nuk e arsyeton sjelljen e projekt buxhetit të njejtë të propozuar në shtator i cili buxhet nuk mori mbështetjen e anëtarëve të Kuvendit për miratim pa ndryshim dhe pa aprovimin e vërejtjeve që ka marrë gjatë shqyrtimit në shtator për shkak të shkeljeve ligjore që ka mbrenda vetëvetës ky buxhet. Ne si grup i anëtarëve të Kuvendit nga PDK-ja nuk e kuptojmë për kundër kohës që keni pasë nuk keni ndërhy fare në vërejtjet që kemi dhënë për ndryshimin e këtij projekt buxheti dhe ndoshta llogaritni në numra për ta aprovu mirëpo gjatë debatit edhe ju do të bindeni vetë se sa hapsirë keni pasur ta përmirësoni dhe të mos kemi shkelje ligjore, mohimi i kopetencës etj.

Pastaj bëri leximin e fjalës së përgatitur me shkrim lidhur me kategoritë e veqanta të buxhetit si të planifikimit dhe shpenzimeve duke krahasuar planifikimet me vitet paraprake dhe për vitin 2018 i cili material është pjesë përbërëse e këtij procesverbal. Në fund tha se te investimet kapitale nuk janë specifiku sakt se në cilat rrugë, lumenj, kanalizim do të investohet dhe për të gjitha këto Kuvendi duhet ta dijë sakt. Në këtë buxhet mungon planifikimi apo më mirë me thënë nuk është parapa asnjë cent për ujë të pijëshëm, për ujëra të zeza është parapa vetëm një kolektorë për Bujan dhe Breg të Zi. Për hapësirat e gjelbërta nuk janë parapa mjete e as për projektin për lumin "Sitnica". Gjithashtu propozoj që të parashihen mjete për ngritjen e lapidarëve dhe pllakave përkujtimore për dëshmorë meqë nuk është parapa asnjë cent as për vitin 2019 as 2020. Gjithashtu nuk janë parapa mjete për deponi të egëra.

Ne si grup parlamentar i PDK-së pa u përfshi vërejtjet tona që i dham tani edhe më herët nuk do ta votojmë këtë projekt buxhet.

Selatin Retkoceri, përshëndetje për të gjithë, unë nuk do t'i përsërisë ato që thanë para folësit dhe pajtohem me shumicën e tyre që u thanë. Do të ndalem në disa prioritate që kanë qenë gjatë fushatës për të gjithë neve shembull te zhvillimi ekonomik, bujqësia, arsimi, shëndetësia, infrastruktura e tj. Unë personalisht kam vërejtje të mëdha në këtë buxhet sepse nuk shoh asgjë në te që garanton zhvillimin ekonomik jo vetëm për vitin 2018 por as në vitin 2019 dhe 2020. Me këto politika qytetarët e Lipjanit nuk mund të presin zhvillim ekonomik për

tre vjeqarin e ardhshëm sepse investime kapitale ka pak. Ne e dijmë se komuna nuk krijon vende pune por në drejtoratin për ekonomi dhe zhvillim nuk e pashë se ish nda ndonjë buxhet që përgadit politikat për zhvillim ekonomik. Te bujqësia dihet se Lipjani është vend agrar dhe 8 mijë familje varen direkt nga bujqësia dhe kur e shqyrtojmë këtë buxhet në detaje shihet se sa pak i është kushtu kujdes këtij sektori kaq të rëndësishëm. Ka një tendencë të rritjes së investimeve në arsim por bazuar në gjendjen e keqe që kemi në arsim ky buxhet është i pa mjaftueshëm. Te shëndetësia është problem i madh edhe për kundër rritjes së parapa është i pa mjaftueshëm ky buxhet. Te politikat orientuese siqë janë rrugët e lagjeve, ndriqimi, troturaret etj. kanë kohë dhe është mirë që këto mjete të orientohen në rregullimin e impiantëve për ujërat e zeza. Me këtë buxhet të hyrat janë rritur për 16% por kemi zvogëlim të të hyrave vetanake dhe kjo tregon se ka stagnim në zhvillimin ekonomik ose me këtë ka tendencë për ruajtjen e titulli kampion që do të thotë t'i zvogëlojmë të hyrat pastaj dalim me rezultat pozitiv. Për paga dhe mëditje në arsim, Shërbime Publike, administratë nuk ka planifikim për rritje. Subvencionet dhe transferet nuk janë rritë dhe kanë mbetë siqë kanë qenë më parë. Te zyra e Kryetarit subvencionet në shumë prej 107.672€ janë pak. Te shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjente ka rënje të investimeve. Te planifikimi urban dhe mjedisi edhe këtu ka rritje. Te shëndetësia dhe mirëqenia sociale ka rritje por është e pa mjaftueshme. Në fund tha se planifikimi i rrugëve është dashtë të ceken me emra.

Egzona Fazlija, fillimisht përshëndeti të pranishmit e pastaj njoftoi se Nisma për Kosovën dega në Lipjan ka shqyrtuar buxhetin për vitin 2018 dhe lidhur me të njëjtin paraqiti fjalën e përgatitur me shkrim e cila sajton pjesën përbërëse të procesverbalit.

Ukë Kryeziu, në këtë mbledhje po e shqyrtojmë buxhetin për vitin 2018 i cili është dashtë të aprovet më herët por për shkak të rrethanave që i dijmë të gjithë është shty deri me sot. Ky buxhet është buxhet elektorale dhe është i njëjti si në shtator që nuk e kemi aprovuar për arsye se projektet e parapara për asfaltimin e rrugëve nuk janë parapa me emra dhe kemi raste kur rrugët u janë shtruar vllaznillakut dhe fare nuk kanë qenë publike, gjithashtu lumenjtë kanë emra por nuk janë përmend me emra se ku do të investohet në këtë mënyrë ne nuk mund ta aprovojmë. Unë jam i knaqur për investimet që janë bërë në Slllovi e gjithashtu edhe rritjen e mjeteve në shëndetësi në mallra dhe shërbime.

Afrim Miftari, unë në emër të subjektit që përfaqësoj AKR-ne ju njoftoj se e kemi shqyrtuar këtë projekt buxhet i cili buxhet ka rritje krahasuar me vitin e kaluar dhe si grup parlamentar i AKR-se e përkrahim.

Lumturije Bytyqi-Hasani, fillimisht përshëndeti të pranishmit e pastaj tha se gjatë fushatës zgjedhore është proklamuar me të madhe përmirësimi i gjendjes në shëndetësi por me këtë buxhet nuk do të ketë përmirësim në shëndetësi. Gjithashtu me projektet e parapara në këtë buxhet nuk e shoh se do të ketë zhvillim ekonomik. Në vazhdim tha të gjithë e dijmë se gjysma e qytetarëve të Lipjanit nuk kanë ujë të pjeshëm dhe me këtë buxhet nuk është planifikuar investim për projektet për ujë. E gjithashtu problem janë edhe ujërat e zeza. Pastaj tha se me këtë buxhet është dashtë të parashihet një projekt për zonën ekonomike të Kërqevës ku do të krijoheshin vende të punës. Te zyra e Kryetarit janë parapa 107 mijë euro pa u specifikuar se ku do të ndahen këto mjet a ne e dijmë se kjo është kompetencë ekskluzive e Kuvendit e ne sot këtë kompetencë po ja dërgojmë Kryetarit në mënyrë që këto mjete t'i ndaj ai kjo nuk është në rregull.

Argjent Tasholli, fillimisht përshëndeti të pranishmit e pastaj tha se në këtë planifikim buxhetor ka projekte të mira por jo në kohën e duhur si psh. rrugën e planifikuar për rregullim prej Gadimes së Ulët e deri te pishat e fshatit. Unë si përfaqësues i kësaj ane nuk e shoh të arsyeshme që të ndërtohen rrugët për relaks kurse kemi rrugë në fshatin tonë të pa shtruar në brendi si psh. rruga e Lumit, rruga e Shkupit, rruga e varrezat e lagjes Ejupi, rruga e Xhamisë etj. prandaj nuk është njerëzore që të investohet dikun për relaks deri sa kemi qytetar dhe fëmijë të cilët ecin nëpër baltë çdo ditë.

Egzona Bytyqi, fillimisht përshëndeti të pranishmit e pastaj tha se nuk është tendencë e imja me bërë kundërshtim pa argumente dhe pa baza për këtë buxhet për vitet 2018-2020 por e ndiej obligim moral për ata që më kanë votuar që t'i parashtroj para jush ato qështje që për neve janë esenciale. Fillimisht unë do të tinglloj si lokaliste mirëpo pa tjetër duhet me i përmend disa qështje që është dasht të paraqiten për fshatin tim me këtë buxhet. Për vitin 2018 për Qylagë është parapa vetëm një projekt për një fushë që sipas mendimit tim është e pa nevojshme. Për Qylagë kisha me i përmend tri qështje që duhet të parashihen me këtë buxhet. E para asfaltimi i rrugicave mbrenda fshatit, rregullimi i oborrit të shkollës dhe meremetimi i shkollës, meqe në shkollë mungojnë qështjet më elementare siqë është uji dhe nyjet sanitare. Unë jam për modernizimin e fshatrave siqë janë trotuaret, ndriqimi etj. por jo këto të bëhen para atyre që janë bazike për qytetarët.

Shkelzen Bislimi, kam pyetje apo sqarim si shembull projektet që kanë përfundu në vitin 2017 janë parapa edhe në vitin 2018 siqë është ndërtimi i sheshit "Adem Jashari", pyes se a është vazhdim i projektit apo është borxh i vitit 2017 kërkoj sqarim nga drejtori i buxhetit.

Me këtë buxhet në fshatin Gadime e Ulët përmendet kompleksi sportiv te Shpella në kodrën e Murturit dhe pyes se a është më mirë që ky kompleks sportiv të bëhet te shkolla- në rrafsh apo në kodrën e Murturit. Tjetra është se në Gadime më mirë ka qenë që të bëhet një sallë e leximit dhe një bibliotekë dhe a ka mundësi që me buxhetin 2018-2020 të parashihet salla e leximit dhe biblioteka.

Nazmi Krasniqi, të gjithë e dijmë se ka vështësi në këtë vit për realizimin e këtij projekt buxheti por mua më intereson ngritja e cilësisë në arsim ku e përmendi edhe ish Kryesuesja. Në këtë buxhet edhe më herët kemi kërku që të gjitha rrugët të cilat kanë m'u asfaltu të ceken me emër mirëpo edhe tani nuk janë parapa me emër. Te ekonomia e shkollës e kemi mjaft problem dhe me këtë buxhet nuk është parapa as një cent për ekonominë e shkollës e gjithashtu përmendi se me ekonominë e shkollës - komunën dhe me Norgesvelin ka qenë një memorandum për 5 vjet i nënshkrum. Në fund pyeti se për punëtorët e arsimit të cilët shkojnë në pension në këtë vit a janë parapa 3 paga ashtu siqë parashihet me Ligj.

Ramiz Qeriqi, përshëndetje pjesërisht kur e them fjalën pjesërisht kuptohet jo për ata që erdhën me vota të blera dhe ata që erdhën me vota të korruptuara qysh e dini edhe ju dhe jo ata që janë këtu që dikur ishin kundër neve dhe interesave kombëtare. I uroj sukses Kryetarit të ardhshëm që ishte edhe vjet dhe vjet e kemi prurë na që jemi në këtë anë kurse tani ka ardhur tu i ble anëtarët të cilët e prunën këtu. Kryetari vjet ka hjek tu i ble me vende pune dhe premtimet që i ka dhënë ishalla nuk i dalin kurrë. Na e dijmë qka ka thënë për Krojmir dhe disa fshatra tjera dhe e dijmë se të gjitha të pamet i ka shfrytëzu duke thënë qitmnat votën se ta maroj këtë rrugë apo atë rrugë. Unë ju uroj sukses dhe ishalla Zoti i mallkon ata që kanë ardhur të korruptuar. Më kujtohet kur Kryetari i thojke Shukri Bujes e ki vendin në burg, por edhe këtu dikush në asamble dhe në qeveri e kanë vendin në burg.

Imri Ahmeti, fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe pastaj uroj punë të mbarë të gjithëve e gjithashtu i uroj punë të mbarë ish Kryesueses së Kuvendit e cila për 4 vite udhëheqi mirë punën e Kuvendit. Sa u përket pyetjeve unë nuk do të lëshohem në të gjitha pyetjet se fushata ka përfundu dhe qytetarët e kanë dhënë vendiktin. Tavanet buxhetore nuk i cakton komuna por qeveria dhe këtu kemi të bëjmë me buxhetin për vitin 2018. Të qenit në pozitë nuk do të thotë që të aprovohet ajo që nuk duhet me u aprovu dhe të qenit në opozitë nuk do të thotë që të mohohet ajo që duhet të aprovohet. Unë po u them se ky buxhet ka ndryshime krahasuar me projekt buxhetin që ka qenë në shtator por në bazë të diskutimeve e pashe se dikush fare nuk e ka lexu këtë buxhet.

Te kanalizimet nuk i kemi adresu se në cilat kanalizime do të investohet se nuk e dijmë cili kanalizim do të mbyllet apo do të shpërthej.

Te lumenjtë nuk e dijmë se cilët lumenjë do të vërshojnë dhe cili duhet të hapet për t'i evitu vërshimet. Në vitin 2013 Lipjani ka pasur 3 milion euro për investime kapitale kurse tani

ka mbi 5 milion. Unë e di që buxheti nuk është ideal nuk i përmbush të gjitha nevojat por kaq kemi pasur mjete dhe i kemi planifikuar.

Për "Sitnicën" mos e bëni buxheti ju se janë parapa 1 milion e 200 mijë euro por jo me buxhetin tonë.

Te subvencionet të Kryetari keni dhënë vërejtje por edhe ju e dini se shumica e këtyre subvencioneve janë për Bashkësinë Islame. U përmendën edhe udhëtimet zyrtare dhe ju them se asnjë cent nuk është shpenzuar për udhëtime zyrtare të brendshme por këtu është fjala për bartjen e nxënësve. Unë qdo ide konkrete që vjen nga opozita e ftoj pozitën që ta aprovonë.

Lulzim Rrustemi, unë i bëra disa pyetje për drejtorin por drejtori nuk u përgjigj dhe ka obligim me u përgjigj. Kryetari u mundu me na bind duke i arsyetuar disa specifikacione të cilat nuk janë në buxhet dhe mos të thotë se na nuk e kemi lexuar buxhetin se projekt buxheti ka qenë edhe në shtator dhe kemi dhënë vërejtje për emërtimin e disa rrugicave në qytet dhe arsyetimi ka qenë se nuk ka pasur vend për t'i shënuar emërat e rrugëve por edhe tani nuk janë shënuar emrat e rrugëve por thuhet rrugicat në Lipjan dhe dihet se nuk ka rrugica në 100 metra por ato janë rrugë të lagjeve dhe duhet të cekem me emër se cilat rrugica janë dhe kjo kompetencë është ekskluzivisht e Kuvendit dhe Kuvendi vendos se për cilat rrugë dhe kështu si keni vepru ju dine se kjo është shkelje ligjore.

Imri Ahmeti, unë nuk bëjë buxhet sipas qefit tënd Lulzim se që 4 vite ju nuk e keni aprovuar buxhetin dhe sikur këtë buxhet edhe tani ta bëjmë siqë thu ti prap nuk do ta votoni.

Vlora Limani-Hajnuni, ky buxhet siqë e tha edhe Kryetari është kështu moti në duar tona e sidomos të antarët e vjetër të Kuvendit. Kryetari me zemër gjësi ftoj pozitën që të aprovohet edhe propozimet e opozitës por opozita është dashtë me dhënë propozim konkret se qka me parapa në këtë buxhet dhe qka me hëkë se nëse aprovohet ajo qka propozon opozita pa mbulesë buxhetore atëherë kuptohet se rritet buxheti dhe MEF-i nuk do ta aprovon buxhetin.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se Kryetari duhet të na përgjigjet neve për pyetjet që i bëjmë e jo me na tregu neve qka ne duhet me pyet atë.

Argjent Tasholli, po shihet se Kryetari ka emocione dhe unë propozoj që në Gadime në vend të ndërtimit të rrugës të pishat të ndërtohet sheshi afër shpellës dhe vend parkimet për vizitorë.

Pasi diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e buxhetit për vitin 2018-2020 dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për, 12 kundër dhe 2 apstenime miratoi këtë:

VENDIM

MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2018-2020

Neni 1.

Me këtë Vendim aprovohet Buxheti për vitet 2018-2020 për Komunën e Lipjanit.

Neni 2.

Buxheti për vitet 2018-2020 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020
Grant i Përgjithshëm	5,293,051.00	5,805,336.00	6,550,574.00
Grant Specifik i Arsimit	6,172,567.00	6,462,677.00	6,818,125.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	1,569,347.00	1,726,282.00	1,950,698.00
Të hyrat vetanake	1,936,600.00	2,007,452.00	2,078,303.00
Financimi Shërbimet Rezedenciale	160,000.00	160,000.00	160,000.00
Huamarrje në Arsim	46,355.00	27,040.00	0.00

Huamarrje në Shëndetësi	138,252.00	138,252.00	0.00
TOTALI	15,316,172.00	16,327,039.00	17,557,700.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020
Paga e Mëditje	8,779,400.00	8,899,802.00	9,002,492.00
Mallra dhe Shërbime	1,325,201.00	1,313,613.00	1,186,199.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	198,390.00	198,390.00	198,390.00
Subvencione dhe Transfere	329,067.00	291,258.00	297,730.00
Investime Kapitale	4,684,114.00	5,623,976.00	6,872,889.00
TOTALI	15,316,172.00	16,327,039.00	17,557,700.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Web faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve.

Neni 6.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 11,⁴⁵

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi